



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
UNIVERSITETI I SPORTEVE TË TIRANËS
SENATI AKADEMIK

Nr. 1848 / Prot.
19

Tiranë, më 21.12.2021

VENDIM

Nr. 148 Datë 21.12.2021

**PËR
HAPJEN E PROCESIT PËR APLIKIM TË KADIDATËVE PËR ANËTARË
PËRFAQËSUES TË UNIVERSITETIT TË SPORTEVE TË TIRANËS
NË BORDIN E ADMINISTRIMIT**

Në zbatim të Ligjit 80/2015 "Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në IAL-të e Republikës së Shqipërisë", neni 48, të Statutit të UST-së, neni 42, në Rregulloren e Brendshme të UST-së neni 23, Senati Akademik në mbledhjen e datës 21.12.2021

VENDOSI:

1. Fillimin e procesit për rregjistrimin e kandidatëve për anëtarë të Bordit të Administrimit përfaqësues të UST-së, të cilët duhet të vetëkandidohen në Sekretarinë e Senatit Akademik.
2. Regjistrimi pranë Sekretarisë së Senatit Akademik të UST-së do të bëhet nga data 21.12.2021 - 12.01.2022 ora 10.00-14.00.
3. Të katër Njësitë Kryesore do të rregjistrojnë kandidatët e tyre dhe nga Senati Akademik do të përzgjidhet me votim një përfaqësues për secilën Njësi. Në një votim të dytë, nga 4 (katër) përfaqësues të stafit akademik, Senati përzgjedh 3 (tre) prej tyre si anëtarë në Bordin e Administrimit.
4. Sekretaria e Senatit Akademik të përpilojë "Njoftim" për të gjithë të interesuarit me të dhënat e sakta për kriteret, mënyrën, vendin dhe periudhën kohore të aplikimit.
5. Ngarkohen për zbatimin e këtij Vendimi, drejtuesit e njësive kryesore si dhe Sekretari i Senatit Akademik.
6. Ky Vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYETARI I SENATIT AKADEMIK

Prof. Dr. AGRON KASA



NJOFTIM

“PËR HAPJEN E RREGJISTRIMEVE PER APLIKIM PËR ANTARË TË BORDIT TË ADMINISTRIMIT PËRFAQËSUES TË UNIVERSITETIT TË SPORTEVE TË TIRANËS.”

Në zbatim të Ligjit 80/2015 “Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në IAL-të e Republikës së Shqipërisë”, neni 48, të Statutit të UST-së, neni 42, Vendimit të Senatit Akademik të UST-së me nr. 143 datë 21.12.2021 ftohen anëtarë të asamblesë akademike të njësive kryesore të UST-së për të bërë vetëkandidimin pranë Sekretarit të Senatit Akademik, Prof.Asc.Dr Robert Çitozi, si me poshtë:

1. Rregjistrimi fillon në datën 21.12.2021 – 12.01.2022, nga ora 10.00-14.00;
2. Vendi i rregjistrimit: Zyra e Prof.Asc.Dr Robert Çitozi / Sekretar i SA.
3. Bordi i Administrimit të UST-së ka gjithsej 7 anatarë nga të cilët 3(tre) janë nga asambleja akademike e njësive kryesore, të cilët do të përzgjidhen nga Senati Akademik i UST-së sipas listes se paraqitur nga Sekretari i Senatit ne përfundim të afatit kohor të kandidimit.
4. Të katër njësitë kryesore do të rregjistrojnë kandidatët e tyre dhe nga Senati Akademik do të përzgjidhet me votim një përfaqësues për secilën njësi. Në një votim të dytë, nga 4 (kater) përfaqësues të stafit akademik, Senati përzgjedh 3(tre) prej tyre si anëtarë në Bordin e Administrimit.
5. Të drejtën për të aplikuar për BA e kanë antarët e asamblesë akademike:
 - Të cilët nuk mbajnë asnjë post autoriteti drejtues në UST-ë;
 - Janë anëtarë të asamblesë akademike me kohë të plotë;
 - Të zotërojnë të paktën gradën shkencore “Doktor”;
6. Kandidatët duhet të paraqesin në momentin e regjistrimit Kartën e Identitetit/ Pasaportën.

SEKRETARI I SENATIT AKADEMIK

Prof.Asc.Dr Robert Çitozi

